



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V\_346\_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_545\_01\_11

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_545\_01\_11**;
6. Apelimi i KEK-ut me datë 23.02.2011;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Mevlude Behrami (shifra e konsumatorit DPR – 21737) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 14.04.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.03.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 05.12.2008 konsumatori ka bërë kërkesë për mbylljen (pasivizimin) e kartelës (shifrës) DPR – 21737 me ç’rast ka bërë pagesën e borxhit total në shifrën si dhe ka hy në parapagim.  
**Provë:** Aplikacioni për mbylljen e kartelës (shifrës) i datës 05.12.2008
- Me kërkesë të konsumatorit me datë 20.12.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe të njëjtën kanë shkyçur nga rrjeti.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 170675
- Me datë 04.03.2009 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për lidhje të re duke plotësuar aplikacionin për lidhje të re.  
**Provë:** Aplikacioni për lidhje të re i datës 04.03.2009
- Me datë 02.04.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se duhet të bëhet ndërrim njehsori.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 000861 i datës 02.04.2009
- Në muajin 05/2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori bazuar në kërkesën për lidhje të re të datës 04.03.2009 si dhe procesit nr. 000861 datë 02.04.2009 kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga



matja njehsorin elektrik nr. 10811897 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 9059810.

**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 002436 i datës 05/2009

- Me datë 07.08.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 10811897, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (blloibat) shtetërore i ka të manipuluar të hapura dhe prapë të mbyllura, vulat shtetërore janë të ndryshme njëra e vitit 1984 kurse tjetra e vitit 1991, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, për rreth kapakut nga ana e djathtë është futur shiriti filmik ku është penguar puna e diskut si dhe në brendi të njehsorit elektrik ka pluhur të shiritit filmik.

**Provë:** Procesverbali me nr. 16/07 i datës 07.08.2009

- Me datë 16.02.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 231403 i datës 16.02.2010

- Me datë 24.02.2010 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR10HP08271 në vlerë prej 456.14 €.

**Provë:** Fatura DPR10HP08271 e datës 24.02.2010

- Me datë 10.03.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 22.03.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.

**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 22.03.2010

- Me datë 14.04.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

- Me datë 17.01.2011, DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK\_V\_545\_V\_01\_11, dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka aprovuar ankesën e konsumatorit dhe ka arritur në përfundim se:

1. KEK-u duhet të shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR10HP08271 të datës 24.02.2010 në vlerën 456.44 €.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_545\_01\_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK-së. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK\_V\_545\_01\_11** të mbetet në fuqi.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar